



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:045385

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05745634

P.nr.273/19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren **Ilirjana Hoti**, dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të pandehurit B. D. nga fshati . . . Komuna Gjakovë , i pandehur për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2-1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , duke vendosur në bazë të aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë PP.nr.858/18 të datës 06.08.2018, komfor nenit 248 par.1 pika 1.3 të KPPK , jashtë shqyrtimit me **datë 28.05.2024** morri këtë :

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza i Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, dhe **PUSHON** procedura penale kundër të pandehurit B. (S.) D. nga fshati . . . Komuna Gjakovë me ID. . . , i pandehur për veprën penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 - 1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale , nga neni 107 par.8 lidhur me nenin 106 par.1 pika 1.5 të KPRK.

Të dëmtuarit M.Z. dhe S. Z. nga nga fshati . . . Komuna Gjakovë , për të realizuar kërkesën e saj pasurore juridike për kompensim dëmi, udhëzohet në kontest civil,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.858/18 të datës 06.08.2018, ka akuzuar të pandehurit M.Z. dhe S. Z. për shkak të veprës penale Vetëgjyqësi në bashkëkryerje nga neni 418 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të pandehurit B. dhe A.D. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 -1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Gjykata kundër te akuzuarit B. D. me dt. 17.04.2019 , ka pezulluar procedurën dhe ka lëshuar urdhër arrest P.nr.542/18 me dt.17.04.2019, me qene se i njëjti nuk ka marr pjesë ne seancat e caktuara ,mirëpo përmes njoftimit nga st. policor dt. 22.01.2019 ,me nr. Ref 04/1-08-GJ-S-26/19 duke vepruar sipas urdhëresës për shoqërim me detyrim jemi njoftuar se i njëjti është kërkuar ne shtëpinë e tij por nuk është gjetur ,e nga vëllai i tij B.D. i cili ka këtë nr. tel . . . jemi njoftuar se B. gjendet në Gjermani..

Gjykata me aktvendimin P.nr. 542/18 te dt. 17.04.2019, ka veçuar procedurën penale për te akuzuarin B. D. dhe për të njëjtin procedura penale do te zhvillohet ndaras me nr. te ri te lendes P.nr. 273/19.

Gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës konstaton se i pandehuri B. D. , dysohet për veprën penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 -1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të kryer me datë 26.05.2018 , e që prej asaj kohe e gjerë me ditën e sotme kanë kaluar me shumë 6(gjashtë) vite, çka do të thotë se ka kaluar dyfishi i kohës se afatit të parashkrimit –ndalesa absolute mbi ndjekjen penale.

Duke marr parasysh se për veprën penale Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 -1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet dhe Gjykata gjeti se në rastin konkret ka ardhur gjerë te parashkrimi absolut i ndjekjes penale konform nenit 107 par.8 lidhur me nenin 106 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit nuk mund të ndërmerren kurrfarë veprimesh për ndjekje penale.

Duke u bazuar në të dhënat e cekura më lartë, konform nenit 248 par.1. pika 1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.273/19 me dt.28.05.2024

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gjyqtarja,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 5 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë , përmes kësaj Gjykate .